- Është detyrë e zbatuesve të projektit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social.
- Është detyrë e Njesise Vendore gjithashtu të zbatojë rigorozisht detyrimet e përcaktuara për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.
- Është detyrë e të gjith kontraktorëve e nënkontraktorëve të ndryshem si gjatë fazës së aktivitetit të zbatojnë me kujdes detyrimet përkatëse të parashikuara më sipër.

❖ Masa lehtësuese të tjera të kërkuara

- Do të bëhet një menaxhim sa më me eficient të energjisë elektrike. Impiantet e nevojshme janë projektuar në përputhje me Ligjin e ri, nr.9379, datë 28-04-2005 “Për Eficencën Energjisë”, kjo do të çoj në uljen e ndotjeve termike të mikroklimës së zonës si dhe kursim të energjisë elektrike nga përdorimi i makinerive/impianti me eficientë.
- Përcaktimi i vend-parkimit të automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistikën përkatëse.
- Subjekti të kryej aktivitetin vetëm brenda kordinatave të sipërfaqes së tokës që disponon ne pronesi.
- Do të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyre periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emëtimin e gazeve dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari të mundshme teknike të mjeteve.
- Shfrytëzimi do të bëhet në mënyrë të tillë që të shmangë në maksimum dëmtimin e burimeve ujore, devijim e rrymave ujore, erozionin dhe dëmtimin zonave përreth.

- Do të instalohet sistem i ujitjes për mjedisin përreth (varet dhe nga hapësira e planifikuar për gjelbërim si dhe pozicioni që ato do të kenë) si dhe lagia me ujë e rrugicave të brëndshme.
- Linja e depozitimit dhe mbushjes së boteve në objekt, do të koluadohet në mënyrë periodike nga teknikë të specializuar dhe çertifikuar për të tilla procese.
- Veglat/Pajisjet/Makinerite e punës që shërbejnë për procese të ndryshme do të zëvendësohen me të reja, sipas jetëgjatësisë së tyre dhe efikasitetit që kanë në kryerjen e operacioneve për mbushjen e boteve.
- Ambienti i zyrave dhe pajisjet/mjetet në zonën e shfrytëzuar do të lyhet periodikisht me bojë higjienike dhe antikorrozive, me qëllim plotësimin e kushteve Higjieno-Sanitare.
- Do të bëhet menaxhimi i mbetjeve të ngurta, të cilat do të jenë; lëndë të aballazheve, letra-kartona, si dhe lëndë organike të prodhuara nga punonjësit dhe klientat, ku këto mbetje do të transportohen rregullisht në vendin e caktuar nga Njësia Vendore, ku firma do të marrë masa për menaxhimin e këtyre mbetjeve të ngurta, do të vendosen në kosha selektive sipas rrymave specifike të mbetjeve.
- Do të bëhet pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave teknologjike dhe ujit të shiut në këtë objekt ose e mjedisit përreth drejt mjediseve të gjelbëruara, një mundësi e mirë dhe për vaditje dhe shmangie të derdhjes së tyre në mjedis si dhe shmangie të përdorimit të ujit të pijshëm për vaditje. Mjedis i gjelbëruar përreth do të jetë nën kujdesjen e personelit që do të punësohet vetëm për punimet agro-mjedimore të nevojshme.
- Rrjeti elektrik është togëzuar për të shmangur ndonjë shkarkesë elektrike, konform kushteve teknike,
- Zona ku do të realizohen Aktiviteti është e rrethuar, me qëllim për të shmangur hyrjet e paautorizuara të individëve të ndryshëm.
- Janë ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme të mbrojtjes kundra zjarrit. Për të mbrojtur kundër zjarrit të mundshëm që mund të bjerë do të ruhen largësitë mbrojtëse ndaj zjarrit të objektit dhe linjës së mbushjes së boteve.
- Aktiviteti i disponon infrastrukturën e nevojshme, me distancat e përcaktuara për rrugë kalim të punonjësve, automjeteve, zjarrëfiksive, etj.
- Është ndërtuar sistemi i drenazhimit të ujrave teknologjike dhe lëvizjes së ujërave të shiut.
- Ndërsa në lidhje në burimet e furnizimit me ujë, janë të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat gjatë një viti, veçanërisht gjatë muajve të verës, kur normalisht kërkesa është më e lartë. Furnizimi me ujë sigurohet në një nivel të tillë presioni, në mënyrë që të jetë i mjaftueshëm për të shpërndarë sasinë e nevojshme të ujit në të gjithë gjatësinë e objektit dhe instalimit, por jo aq sa të demtojë pajisjet hidraulike (efekti i grushtit hidraulik) ose të krijojë rreziqe tek impianti apo aparatat dhe jetën e punonjësit.
- Do të bëhet trajnimi periodik i punonjësve mbi kushtet e sigurimit teknik gjatë operimit të punës, si dhe të kualifikohen stafit përgjegjës për operimin e punës në aktivitet.

- **Masat lehtesuese qe do të ndermerren gjate funksionimit te aktivitetit.**

Vlerësimi i ndikimit në mjedis duhet të ndikojë në dhënien e zgjidhjeve për shmangie të ndotjes dhe mbrojtjes së mjedisit. Mbrojta e mjedisit përbën në vetvete një sërë masash zbutëse, parandaluese.

Në mënyrë të përgjithshme do të japim disa prej masave që do të zbatohen nga Shoqëria për funksionimin e Aktivitetit. Ndikimet negative në mjedis gjatë funksionimit të Aktivitetit janë në nivele të ulta. Disa prej masave kryesore që do të ndermerren janë permendur në menyrë të përmbledhur si më poshtë:

- Menaxhimi optimal dhe mirembajtja e Depozitave të mbetjeve.
- Mbetjet e ngurta urbane dhe ato industriale që do të prodhohen në objekt të depozitohen në vëndet e përcaktuara nga Njësia Vendore dhe të vendosen kontener të mjaftueshem për mbetjet për numrin e punonjësve, si dhe riciklimin e tyre nga subjekte të licencuara.
- Rikuperimi, Riciklimi dhe Riperdorimi i mbetjeve të gjeneruara nga Aktiviteti në qofte se është e mundur.
- Kapja dhe trajtimi i pluhurave dhe gazeve nepermjete filtrave dhe nderrimi periodik i tyre sipas kapacitetit mbajtes.
- Të respektohen oraret e operimit të punës brenda mjedisit ku zhvillohet aktiviteti për depozitim të karburanteve.
- Automjetet e transportit të qarkullojnë me shpejtësi të ulët në teritorin e Aktivitetit dhe në zonat e banuara pranë Subjektit.

- ❖ **Menaxhimi i Instalimit**

Menaxhimi i instalimit bëhet nga një staf i kualifikuar dhe trajnuar për të operuar dhe për të ushtruar aktivitetin, për të cilin Shoqëria "KASTRATI" Sh.a operon në tregun rajonal dhe me gjere. Për zhvillimin e aktivitetit të kësaj Shoqëria konform të gjitha rregullave, teknike, tatimore, fiskale dhe atyre mjedisore, është organizuar puna në mënyrë të tillë që të funksionojë në formën e një organogramme për realizimin sa më eficient dhe të sukseshem, e cila tregon mënyrën e funksionimit, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësitë të secilit.

- ❖ **Menaxhimi i Aktivitetit**

Për mbrojtjen e instalimit nga bllokimi apo avaritë e ndryshme teknike rënia nën tension, rënia e zjarrit, bllokimi i impiantit/makinerive nga papastërtitë nga elemente të ndryshme, lëvizja e punonjësve dhe mjeteve të transportit të brendshëm, etj janë marre keto masa:

- Përreth depozitave ruhet distanca e sigurisë, e cila është vizuar me vijë të verdhë, përgjatë këtij perimetri lëvizin vetëm drejtuesit teknik dhe punonjësit e autorizuar
- Përcaktimi i vend-parkimit të automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistikën përkatëse.

- Eshte instaluar sistem i ujitjes per mjedisin perreth (varet dhe nga hapësira e planifikuar per gjelberim si dhe pozicioni qe ato kane) si dhe lagia me uje e rrugicave te brendshme gjate periudhes Maj-Tetor, ujrat e pastrimit do të shkarkohen në rrjetin e brendshëm të kullimit dhe nga aty në pusetat dekantuese, dhe me pas ne rrjetin e kanalizimeve te zones, këto ujra nuk janë të ndotura më lëndë me përbërje të rrezikshme.
 - Brenda objektit kryhet menaxhimi i mbetjeve te ngurta, te cilat jene; lende te aballazheve, letra-kartona, qelqe, si dhe lende organike te gjeneruara nga punonjesit, keto mbetje grumbullohen dhe periodikisht depozitohen ne vendin e caktuar nga Njësia Vendore ku jane vendosur kosha selektive. Mbetjet e ngurta urbane te gjeneruara, depozitohen ne kosha brenda territorit te shoqerise me volum 0.5 m^3 prej ku me pas merren nga mjetet e shoqerise dergohen ne koshat e perbashket, nga ku me pas mjetet e pastrimit te bashkise i dergojne ne vendepozitimn e caktuar prej tyre.
Mbetjet industrial te gjeneruara nga proceset e prodhimit te detergjenteve depozitohen ne sheshet e percaktuara nga shoqeria brenda kushteve teknike per depozitimi, magazinimin, transportimin dhe asgjesimin perfundimtar te tyre nga vete proceset teknologjike te linjes se prodhimit te detergjenteve apo nga shoqeri te licencuara per asgjesimin perfundimtar te ketyre mbetjeve.
 - Paisjet e reja jane me te avancuara dhe nje sere veprimesh i kane te automatizuara duke shmangur keshtu nderhyrjen e punonjesve dhe te punuarit prane tyre, per vec te tjerash shoqeria ka disa rregulla strikte te cilat zbatohen me rigorozitet per mos nderhyrjen ne makineri gjate punes, stakimit te energjise para fillimit te kontrollit apo mirembajtjes e remontit te tyre, etj.
 - Karburantet magazinohet brenda objektit ne depozita, ku me pas dergohet ne destinacionet e kerkuara ne varesi te kerkese qe shoqerit e ndryshme kane dhe ne respektim te kushteve te kontratava qe ato kane lidhur me
- Shoqerine "KASTRATI" Sh.a.**

- **Masat lehtesuese qe do të ndermerren gjate funksionimit te aktivitetit.**

Vlerësimi i ndikimit në mjedis duhet të ndikojë në dhënien e zgjidhjeve për shmangie të ndotjes dhe mbrojtjes së mjedisit. Mbrojta e mjedisit përbën në vetvete një sërë masash zbutëse, parandaluese.

Në mënyrë të përgjithshme do të japim disa prej masave që do të zbatohen nga Shoqëria për funksionimin e Aktivitetit. Ndikimet negative në mjedis gjatë funksionimit të Aktivitetit janë në nivele të ulta. Disa prej masave kryesore që do të ndermerren janë permendur në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

- Menaxhimi optimal dhe mirembajtja e Depozitave.
- Mbetjet e ngurta urbane dhe ato industriale që do të prodhohen në objekt të depozitohen në vëndet e përcaktuara nga Njësia Vendore dhe të vendosen kontener të mjaftueshem për mbetjet për numrin e punonjësve, si dhe riciklimin e tyre nga subjekte të licencuara.
- Rikuperimi, Riciklimi dhe Riperdorimi i mbetjeve të gjeneruara nga Aktiviteti në qofte se është e mundur.
- Kapja dhe trajtimi i pluhurave dhe gazeve nepermjete filtrave dhe nderrimi periodik i tyre sipas kapacitetit mbajtes.
- Të respektohen oraret e operimit të punës brenda mjedisit ku zhvillohet aktiviteti për depozitim të karburanteve.
- Automjetet e transportit të qarkullojnë me shpejtësi të ulët në teritorin e Aktivitetit dhe në zonat e banuara pranë Subjektit.

- ❖ **Menaxhimi i Instalimit**

Menaxhimi i instalimit bëhet nga një staf i kualifikuar dhe trajnuar për të operuar dhe për të ushtruar aktivitetin, për të cilin Shoqëria "KASTRATI" Sh.a operon në tregun rajonal dhe më gjere. Për zhvillimin e aktivitetit të kësaj Shoqëria konform të gjitha rregullave, teknike, tatimore, fiskale dhe atyre mjedisore, është organizuar puna në mënyrë të tillë që të funksionojë në formën e një organogramme për realizimin sa më eficient dhe të sukseshem, e cila tregon mënyrën e funksionimit, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi të secilit.

- ❖ **Menaxhimi i Aktivitetit**

Për mbrojtjen e instalimit nga bllokimi apo avaritë e ndryshme teknike rënia nën tension, rënia e zjarrit, bllokimi i impiantit/makinerive nga papastërtitë nga elemente të ndryshem, lëvizja e punonjësve dhe mjeteve të transportit të brendshëm, etj janë marre keto masa:

- Përreth depozitave ruhet distanca e sigurisë, e cila është vizuar me vijë të verdhë, përgjatë këtij perimetri lëvizin vetëm drejtuesit teknik dhe punonjësit e autorizuar
- Përcaktimi i vend-parkimit të automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistikën përkatëse.

- Eshte instaluar sistem i ujitjes per mjedisin perreth (varet dhe nga hapësira e planifikuar per gjelberim si dhe pozicioni qe ato kane) si dhe lagia me uje e rrugicave te brendshme gjate periudhes Maj-Tetor, ujrat e pastrimit do të shkarkohen në rrjetin e brendshëm të kullimit dhe nga aty në pusetat dekantuese, dhe me pas ne rrjetin e kanalizimeve te zones, këto ujra nuk janë të ndotura më lëndë me përbërje të rrezikshme.
- Brenda objektit kryhet menaxhimi i mbetjeve te ngurta, te cilat jene; lende te aballazheve, letra-kartona, qelqe, si dhe lende organike te gjeneruara nga punonjesit, keto mbetje grumbullohen dhe periodikisht depozitohen ne vendin e caktuar nga Njësia Vendore ku jane vendosur kosha selektive. Mbetjet e ngurta urbane te gjeneruara, depozitohen ne kosha brenda territorit te shoqerise me volum 0.5 m³ prej ku me pas merren nga mjetet e shoqerise dergohen ne koshat e perbashket, nga ku me pas mjetet e pastrimit te bashkise i dergojne ne vendepozitimn e caktuar prej tyre.
Mbetjet industrial te gjeneruara nga proceset e prodhimit te detergjenteve depozitohen ne sheshet e percaktuara nga shoqeria brenda kushteve teknike per depozitimi, magazinimin, transportimin dhe asgjesimin perfundimtar te tyre nga vete proceset teknologjike te linjes se prodhimit te detergjenteve apo nga shoqeri te licencuara per asgjesimin perfundimtar te ketyre mbetjeve.
- Paisjet e reja jane me te avancuara dhe nje sere veprimesh i kane te automatizuara duke shmangur keshtu nderhyrjen e punonjesve dhe te punuarit prane tyre, per vec te tjerash shoqeria ka disa rregulla strikte te cilat zbatohen me rigorozitet per mos nderhyrjen ne makineri gjate punes, stakimit te energjise para fillimit te kontrollit apo mirembajtjes e remontit te tyre, etj.
- Karburantet magazinohet brenda objektit ne depozita, ku me pas dergohet ne destinacionet e kerkuara ne varesi te kerkese qe shoqerit e ndryshme kane dhe ne respektim te kushteve te kontratava qe ato kane lidhur me
Shoqerine "KASTRATI" Sh.a.

❖ Sigurimi teknik në proceset e punës

Zbatimi i normave të rregullores së teknikës së sigurimit

Gjatë ushtrimit të aktivitetit Subjekti mban parasysh që problemet e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë janë më të rëndësishmet dhe më të mprehta dhe kërkojnë vlerësim serioz.

- Para se gjithash në të gjitha operacionet jane punësuar specialist me eksperience pune në kryerjen e proceseve të ndryshme të përdorimit të instalimeve.
- Rregullore e Teknikës së Sigurimit, nga ana e drejtuesit teknik të drejtimit te operacioneve, zbatohet në çdo proces pune të përcaktuar në plan organizimin e kryerjes së punimeve të hartuar nga ai dhe të miratuar nga drejtuesit e firmës.

- Plan organizimi i punimeve/prodhimit hartohet para fillimit të cdo operacioni të funksionimit të linjes së mbushjes së boteve.
- Plan organizimi i punës hartohet nga drejtuesi teknik i punimeve
- Drejtuesi teknik i aktivitetit ose personi i ngarkuar në kontrollin teknik dhe azhurnimin e saktë të aktivitetit për të cilat subjekti është licensuar.
- Rradha e kryerjes së veprimeve përcaktohet hollesisht në planin e masave tekniko-organizative dhe është i miratuar nga përfaqësuesi i shoqërisë.
- Në këtë plan tekniko-organizativ masat e teknikes së sigurimit zenë vendin kryesor.
- Drejtuesi teknik i Aktivitetit kryen instruktive të rregullta mujore e tre mujore, ku trajtohen tema të vecanta për të gjitha profesionet dhe operacionet që zhvillohen në aktivitet.
- Kujdes i veçantë tregohet në krijimin e kushteve të punës, pastrimit të objektit dhe instalimit dhe monitorimit të parametrave mjedisore, etj.
- Kujdes i veçantë i kushtohet ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit të zonës

❖ **Plani i menaxhimit të mjedisit**

Çdo veprimtari e rëndësishme që kryhet në marrëdhënie me mjedisin, duhet të parashikojë në projektin e saj edhe Planin e Menaxhimit të Mjedisit (PMM), qëllimi i të cilit është parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit të veprimtarisë që propozohet të kryhet.

Kualifikimi i personelit dhe masat mbrojtëse të përgjithshme. Duhet theksuar që menaxhimi mjedisor është në interes të të gjithëve kundrejt plotësimit të kërkesave. Duhet të zhvillohet një menaxhim mjedisor i detajuar dhe një program trajnimi.

❖ **Plani i Monitorimeve Mjedisore**

Monitorimi i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokës, shkarkimeve etj, kryhet sipas disa kritereve shkencore përsa i përket vrojtimit, mbledhjes dhe analizave të mostrave. Ai synon në mbledhjen e të dhënave për të vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror në ndryshimet e mjedisit, ku ai është aktiv.

Monitorimi i cilësisë së mjedisit mbetet një ndër çështjet parësore. Monitorim është procesi i zbulimit të ndryshimeve nëse do të ndodhin, përcaktimit të drejtimit dhe i matjes së shtrirjes së tyre.

Procesi i monitorimit do të përqëndrohet në të gjithë fazat e zhvillimit të projektit dhe fokusohet në aktivitet që gjenerojnë ndikime negative në mjedis në efektet e këtyre ndikimeve dhe në zbatimin e masave për zbutjen e tyre. Monitorimi do të kryhet nga vetë investori dhe në rast të pamundësisë teknike për realizimin e tyre do të kërkohet bashkëpunim i subjekteve të

specializuara për fushat përkatëse. Verifikimi i monitorimit apo auditimit do të organizohen nga institucionet administrative si AKM-ja, Ministria e Mjedisit, ISHMP etj.

❖ **Masa per sigurimin teknik dhe mbrojtja ne pune**

Gjatë ushtrimit të aktivitetit Subjekti duhet të mbajë parasysh që problemet e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë janë më të rëndësishmet dhe me të mprehta dhe kërkojnë vlerësim serioz.

Para së gjithash në të gjitha operacionet janë punësuar specialistë me eksperiencë pune në kryerjen e proceseve të ndryshme të linjes së mbushjes së bombulave.

Regullorja e Teknikës së Sigurimit, nga ana e drejtuesit teknik të subjektit, do të zbatohet në çdo proces pune të përcaktuar në plan organizimin e kryerjes së punimeve të hartuar nga ai dhe të miratuar nga drejtuesit e firmës.

Plan organizimi i punimeve do të hartohet para fillimit të funksionimit të linjes së mbushjes së bombulave.

Drejtuesi teknik i punimeve ose personi i ngarkuar do të bëjë kontrollin teknik dhe azhurnimin e saktë të linjes së depozitimit dhe të mbushjes së boteve për të cilat subjekti ka marrë licensë.

Rradha e kryerjes do të përcaktohet hollësisht në planin e masave tekniko organizative dhe do të miratohet nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë.

Drejtuesi teknik do të kryejë instruksione të rregullta mujore e tre mujore, ku do të trajtohen tema të vecanta për të gjithë punonjësit.

❖ **Menaxhimi i Instalimit**

Organizimi i punes dhe fuqia punetore

Puna brenda në objekt është e ndarë qartë, dhe secili prej punonjësve realizon ato procese pune për të cilat ai është ngarkuar nga përfaqësuesi i shoqërisë, procesi i mbushjes së boteve është i automatizuar dhe monitorohet nga drejtuesit teknik.

Per Menaxhimin dhe funksionimin e linjes së mbushjes së boteve në një ditë të zakonshme pune, skema e funksionimit është shumë e thjeshtë dhe e mirë organizuar nga Përfaqësuesi Ligjor i Shoqërisë “KASTRATI” Sh.A ecuria e punes është si më poshtë:

- Drejtuesit teknik menaxhojnë plotësisht të gjithë rrethin e punës së impiantit, duke filluar nga regjistrimi i urdhrave të përditshme, listën e procesimit të kërkesës, llogaritjen e ngarkim – shkarkimeve dhe të mbushjes së boteve, menaxhon kohët e dorezimit dhe shkarkimit, kompenson dhe përmirëson gabimet gjatë zhvillimit të Aktivitetit duke përdorur një sistem vetë-korrigjimi.

1. Kontrollon në kohë reale ecurinë e variablave të Aktivitetit dhe paraqet në grafik visual aktivitetin ne ore.
 2. Kontrollon dhe kordinon plotësisht proceset e aktivitetit dhe ofron informacione të vazhdueshme të ecurise se mbushjes se boteve.
- Lejon një gamë të gjerë të programeve të Aktivitetit nëpërmjet menaxhimit dhe trajtimit të operacioneve, të tilla si:
 - Menaxhimin e Porosive
 - Skedimin dhe menaxhimin e dokumenteve të shpërndarjes, me një rend automatik të printimit në fund të procesit të ngarkim-shkarkimit të impiantit te mbushjes.
 - Dokumentet menaxhimit të shpërndarjes madje edhe për ngarkimin manual.
 - Menaxhimin e lëndës së pare, kur hyjnë dhe dalin
 - Menaxhimin e përditshëm të mbushjes se depozitave dhe boteve.
 - Programet e mirëmbajtjes së makinerive dhe paisjeve
 - Ruan një skedar të operacioneve të Impiantit
 - Kontrollon parametrat për shfrytëzimin më të mirë të aftësive të linjes se mbushjes se depozitave dhe boteve.
 - Drejtuesi Teknik kontrollon depozitat dhe njofton për ato që ka më pak në gjendje.
 - Drejtuesi i Panelit te Kontrollit automatikisht informon bazën e të dhënave për lëvizjen e karburanteve në mënyrë manuale apo automatike.
 - Automatikisht arkivon proceset ditore (konsumi në mënyrë automatike apo manuale, litra, etj)
 - Menaxhon kartat mirëmbajtjes së të gjitha automjeteve dhe makinerive të impiantit, të bazuar në lita, apo periudhë kohore
 - Drejtuesi i Panelit te Kontrollit rregjistron manualisht lëvizjet e panelit të operimit.
 - Menaxhon historikun duke iu referuar alarmeve, duke i dhënë mundësinë të kategorizojë dhe printojë
 - Drejtuesi Teknik menaxhon pjesën e depozitimit të karburantit.
 - Punonjesit
 - Drejtojnë operacionet e ngarkim-shkarkimit te karburantit.
 - Mirembajne, kontrolli dhe riparimi i linjes se instalimit/aparaturave
 - Rakordimi i sasise se karburantit te shkarkuar dhe I boteve te mbushura
 - Magazinimin dhe transportimin e karburantit
 - Drejtimin e paisjeve se mbushjes se boteve
 - Montojne dhe cmontojne detale dhe makinerite e paisjeve te demtuara
 - Drejtojnë operacionet per shperndarjen sa me eficient te karburantit
 - Menaxhojne procesin e shperndarjes depozitimit dhe ngarkimit te boteve.

Kryerja e aktivitetit, gjithashtu, favorizohet nga:

- Pozicioni arkitektonik i instalimit dhe hapsira e bollshme ne dispozicion per zhvillimin e te gjitha proceseve per mbushjen e boteve, linjat teknologjike te impiantit punojne ne grup me hapsira ndermjet tyre te cilat nuk pengojne proceset e njera-tjetres.
- Kërkesa e madhe e tregut per karburant.
- Distanca e objektit me zonat e banuara, duke mos ndikuar ne aktivitetin e tyre bujqesor, ekonomik dhe shoqeror.
- Instalimet janë të një teknologjie bashkohore dhe te certifikuar dhe me ISO.

MENAXHIMI I MBETJEVE

Zhvillimi i veprimtarise eshte lidhur me prodhimin e mbetjeve te cilat jane kryesisht mbetje te kontaminuara me hidrokarbure. Kompania zhvilluese "KASTRATI" Sh.a siguron infrastrukturen e nevojshme per menaxhimin e mbetjeve te gjeneruara nga zhvillimi i industries hidrokarbure ne vend.

Menaxhimi dhe klasifikimi i mbetjeve bazohet ne ligjin nr.10 463, date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve" dhe Vendim nr.99, date 18.02.2005 "Per miratimin e katalogut shqiptar te klasifikimit te mbetjeve"

Menaxhimi i mbetjeve te riciklueshme (ambalazhe plastike, letre, kartoni, mbetje metalesh) ndahen dhe grumbullohen ne sheshin e depozitimit (sanitary storage), te cilat jane mbledhur nga kontraktoret e licensuar per menaxhimin dhe riciklimin e tyre.

Mbetjet e kontaminuara me hidrokarbure sipas llojit dhe sasise se tyre dergohen ne facilitetet perkatese per depozitim apo trajtim.

Nje nder parimet me te rendesishme te kompanise "KASTRATI" Sh.a eshte trajtimi dhe eliminimi i hidrokarbureve ne keto mbetje.

Ndertesa e kompanise "KASTRATI" Sh.a e perbere prej 3 kapanonesh te lidhur me njeri tjetrin ben te mundur magazinimin dhe me pas eliminimin e te gjithe mbetjeve hidrokarbure ne zhavorr, balte, rere, uje etj.

Permbledhje

- Efikas, me kosto efektive per riparimin e mjedisit.
- Ky impianti eshte ne gjendje te ofroje rehabilitimin e plate te materialeve te kontaminuara me hidrokarbur ne nje menvre efikase dhe me kosto efektive.
- Reduktimi i garantuar ne me pak se 1% Përrnbajtja totale e hidrokarbureve, me aftesine per te rikuperuar token, rerat ose Argjila per riperdorim.
- Projektet e shkallezuar ne varesi te nevojave te klientit dhe afatet kohore.
- Te afte per trajtimin e mbeturinave komplekse, te mashes ose te biodegraduar dhe te hidrokarbureve te gjata te zinxhirit te pamundur per teknologjite e tjera per t'u adresuar.
- Afati i shpejte per vendosjen ofron projekte efikase per klientet - zgjidhja e ceshtjeve te afta te licencave, pastrimi i shpejte i postpeshimeve ose takimi.
- Afateve te imponuara nga jashte nga agjencite e mjedisit ose nga palet e tjera te interes.
- Efikasiteti i koston nxitet nga thjeshtesia e sistemit: nuk ka tretes ose kimikate te rrezikshme per mjedisin, nuk ka ngrohje te konsiderueshme te procesit, mbetje.
- Lume qe nuk kerkon trajtim te metejshem.
- Makineria dhe teknologjia nuk kerkojne perfshirjen afatgjate te ernigranteve, keshtu qe projektet e rehabilitimit ofrojne mundesi per lokalitete te rendesishme.
- Punesimin, trajnimin dhe transferimin e aftesive
- Ky impiant eshte, pra, ne gjendje te ofroje rezultate te garantuara superior ndaj teknologjise se konkurrenteve me nje kosto atraktive per klientin permes kontaminuarve
- Tokat, liqenet e naftes dhe formate tjera te ndotjes se hidrokarbureve.

Për menaxhimin sa më të sukseshëm stafi i punonjësve të Shoqërisë “KASTRATI” Sh.a që operojnë në objektin ku ndodhet instalimi janë të trajnuar për përballimin e situatave të tilla. Çdo 3 muaj nën kujdesin e Drejtuesit Teknik të shoqërisë, improvizohen skema të ndryshme për përballimin e situatave të tilla, duke rritur performancën e punonjësve dhe sigurimit të punës brenda objektit/instalimit.

Përfaqësuesi Ligjor i Shoqërisë “KASTRATI” SH.A

z. Gani KASTRATI

